



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 30.3.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj.

Munguan : Salih Morina, Sevdije Lama, Etem Arifi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 21.3.2011.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të punës së Komisionit.
4. Propozimi për një anëtar në komisionin shqyrtues në Zyrën Rregullatore për ujëra e mbeturina (ZRRUM) .
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, por **Daut Haradinaj** u interesua a ka nevojë të futet pikë e re për rekomandimin e këtij komisioni për rritjen e buxhetit për ministrinë e bujqësisë dhe të mjedisit, përkatësisht a është miratuar kërkesa e këtij komisioni rreth buxhetit. **Nait Hasani** sqaroi se rekomandimi i komisionit i është dërguar komisionit për buxhet gjë që më tepër nuk mundet ky komision të veprojë, ngase nuk është komision funksional.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 21.3.2011

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa ndonjë vërejtje, përkatësisht me vërejtjen e z. Haradinaj i cili menjëherë është lajmëruar me vërejtje pasi ka marrë procesverbalin në mënyrë elektronike. **Daut Haradinaj** u njoftua për përfshirjen e

vërejtjes së tij në procesverbal ku ka fol për vijën e demarkacionit jo të ujërave por të pyjeve me Malin e Zi.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të punës së Komisionit

Anëtarët e pranishëm shqyrtuan draft planin e punës së komisionit për këtë vit në bashkëbisedim me **Blerim Velën** (OSCE) i cili u kujdes për të njoftuar komisionin rreth prioriteteve nga raporti i progresit Evropian. Duke pasur parasysh raportin e progresit plani i punës për këtë vit u miratua por me një renditje ndryshe të projektligjeve nga ajo që u përgatit në strategjinë e Qeverisë së Kosovës, ndaj kërkesa me këtë rirenditje të projektligjeve do t'ju dërgohet dy ministrive përkatëse, si vijon :

Strategjia legjislative për vitin 2011 nga MBPZHR :

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/ L-098 për bujqësinë dhe zhvillimin rural-30.6.2011

Projektligji për promovimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore-30.9.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/ L-95 për mbrojtjen e bimëve-30.4.2011

Projektligji për pasurimin e miellit-1.11.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/ L-08 për verëra-30.4.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/ 5 për farëra-30.5.2011

Projektligji për shërbimet këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë-30.9.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/ 3 për pyjet e Kosovës-30.5.2011

Projektligji për komasacion të tokës bujqësore-31.10.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02 / L-122 për bujqësinë organike-30.4.2011

Projektligji për kultivimin, përpunimin e produkteve dhe qarkullimin e duhanit-31.5.2011

Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetik-30.4.2011

Strategjia legjislative për vitin 2011 nga MMPH

Projektligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit-30.9.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 200/5 për themelimin e regjistrimit të drejtave të pronës së paluajtshme-30.6.2011

Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore-30.6.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 02/L-30 për mbeturina-15.5.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2004/24 për ujërat e Kosovës-15.4.2011

Projektligji për Qendrën historike të Prizrenit-30.4.2011

Projektligji për Hoqjen e Madhe-30.4.2011

Projektligji për Parqet Nacionale-30.4.2011

Projektligji për Fondin për Mbrojtjen e Mjedisit-30.9.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2004/15 për ndërtimet-30.9.2011

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/ 25 për kadastrë-31.6.2011

Projektligji për Agjencinë për Mbrojtjen nga rrezatimet-30.7.2011

Kjo rirenditje e projektligjeve u kërkuar nga komisioni për shkak të gjendjes alarmante në disa lëmi siç janë pyjet, për shkak të regjistrimit që do të bëhet nga MAP, akciza 45% për verërat tona (favorizimi i “Vranacit” Malazez), kriza ushqimore dhe rezervat ushqimore, si dhe për shkak të politikave bujqësore të BE, të cilat do të ishte absurd mos t'i miratojmë ne, ngase ato për ne janë hartuar.

4. Propozimi për një anëtar në komisionin shqyrtues në Zyrën Rregullatore për ujëra e mbeturina (ZRRUM)

Nait Hasani njoftoi komisionin për sugjerimet e dhëna lidhur me këtë pikë, por konstatoi se sqarimet nuk mjaftojnë sa i përket çështjes së pagesës së anëtarëve të këtij komisioni, ndaj propozoi që kjo pikë edhe një herë të shtyhet për shkak të sqarimeve që duhet bërë nga ana e sekretarisë së Kuvendit, pasi të sqarohet çështja aktuale në Kuvend rreth vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani dhe komisioni konstatuan prioritetet rreth daljeve në terren të komisionit, por paraprakisht nga OSCE dhe administrata do të ishte mirë të bëhet një plan për vizitat nëpër komuna në takimin dy ditorë të paraparë. Pa marr parasysh këtë plan që do të hartohet, komisioni ishte i mendimit që urgjentisht duhet të vizitohen disa komuna, në radhë të parë Rahoveci, Suhareka etj ku fillimisht kryetari i komisionit do të paralajmëronte kryetarin e komunës dhe drejtorët e dy departamenteve (bujqësi e mjedis) për ditën e vizitës. Arsyet për vizitat e komisionit nëpër komuna do të jenë kryesisht ringjallja e bujqësisë prej së cilës degë kanë jetuar me dekada popullata jonë, dëmtimi i pyjeve dhe ruajtja e tyre, licencat për gurthyes, sa fitojnë fermerët nga subvencionet (ngase ato janë për fermer e jo për projekte-**Nijazi Idrizi**), pse ndëshkohen qytetarët tanë me akcizë 45% për prodhimin e verërave (**Daut Haradinaj**), çështjet e ndotjes së mjedisit siç është zbatimi i ligjit për VNM (**Liburn Aliu**) dhe sa më shumë kontakte me fermerin. Sa më shumë që do të del komisioni në terren, aq më efikas do të jetë, ishte konkludimi i komisionit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,25.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani